

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		12/01/2026	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	052/01-1372		

RAPORT I KONSULTIMEVE, DËGJIMEVE DHE TUBIMEVE PUBLIKE PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2025

Komuna e Drenasit



Janar 2025

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje ekzekutive	2
1. Raporti për takimet publike me qytetarë.....	3
2. Raporti për konsultimet publike për projektaktet komunale (takimet konsultative)	4
3. Raporti për konsultimet publike me shkrim apo elektronike (përdorimi i platformës së konsultimeve).....	5
4. Raporti i dëgjimeve buxhetore me qytetarë	7

Përmbledhje ekzekutive

Gjatë periudhës së raportimit, janë realizuar gjithsej **2** takime publike, **5** konsultime publike, **9** dëgjime buxhetore duke përfshirë edhe **1** nga Komiteti për Politikë dhe Financa dhe **2** dëgjime buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 . Këto aktivitete u organizuan me synimin për të përfshirë qytetarët dhe palët e interesuara në procesin e vendimmarrjes dhe për të rritur transparencën institucionale.

Sukseset e arritura përfshijnë rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe ofrimin e një platforme të hapur për shprehjen e ideve dhe shqetësimeve të tyre. Në disa raste, rekomandimet e dhëna gjatë këtyre konsultimeve u reflektuan në vendimet përfundimtare, duke treguar një nivel të mirë të integritit të feedback-ut publik.

Nga ana tjetër, **sfidat kryesore** përfshijnë pjesëmarrjen e ulët në disa zona, sidomos mungesa pjesëmarrjes së gjinisë femërore. si dhe vështirësitë në komunikimin efektiv të rëndësisë së konsultimeve për publikun e gjerë.

Objektivat e përcaktuara për këto konsultime janë arritur në një masë të konsiderueshme, megjithëse ka ende hapësirë për përmirësime. Për më tepër, obligimet ligjore në lidhje me procesin e konsultimeve publike janë përmbushur, duke siguruar përputhshmëri me kuadrin ekzistues ligjor.

Ky raport shërben si bazë për identifikimin e fushave që kërkojnë zhvillim të mëtejshëm për të rritur efikasitetin dhe ndikimin e konsultimeve publike në të ardhmen.

1. Raporti për takimet publike me qytetarë

Gjatë periudhës së raportimit, kryetari i komunës ka organizuar gjithsej **dy** takime publike me qytetarët. Këto takime u mbajtën në **sallën e kuvendit komunal**, për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse ndaj qytetarëve të komunës.

Grupet e targetuara për këto takime ishin përfaqësues nga komuniteti i biznesit, organizatat joqeveritare, të rinjtë, gratë dhe qytetarët e zakonshëm. Aktivitetet u organizuan në institucionin lokal-Komunën e Drenasit, duke mundësuar pjesëmarrjen e një game të gjerë pjesëmarrësish.

Gjatë këtyre takimeve, qytetarët patën mundësinë të diskutojnë çështje të rëndësishme që përfshijnë zhvillimin ekonomik, mirëqenien sociale, infrastrukturën dhe shërbimet publike.

Objektivat e takimeve publike janë arritur në një masë të kënaqshme, duke përfshirë një angazhim aktiv të qytetarëve dhe ndërtimin e një dialogu të hapur ndërmjet institucioneve dhe komunitetit. Ndërkohë, obligimet ligjore të lidhura me organizimin e këtyre takimeve janë përmbushur plotësisht.

Megjithatë, disa sfida përfshijnë pjesëmarrjen e ulët në disa zona më të largëta dhe mungesën e vetëdijes për rëndësinë e këtyre takimeve. Në përgjithësi, takimet publike kanë kontribuar në forcimin e besimit midis qytetarëve dhe administratës komunale, duke ofruar një platformë të vlefshme për bashkëpunim dhe pjesëmarrje aktive në vendimmarrje.

Tabela 1. Raportit për takimet publike me qytetarë

Tabela e përgjithshme					
Komuna	Numri i takimeve publike me qytetarë të organizuara	Numri i pjesëmarrësve në takimet publike (në total)	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë (M. / F)		Numri i procesverbaleve të hartuara dhe publikuara pas takimeve
Komuna e Drenasit	2	94	61	33	2

Verifikimi i të dhënave			
Takimi publik	Data e takimit	Linku i njoftimit të publikuar	Linku i procesverbalit
Takimi i parë me publikun	19.06.2025	https://glogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Tubimi-me-publikun-per-daten-19.06.2025-shqip-dhe-serbisht.pdf	https://glogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Procesverbali-i-tubimit-te-pare-me-publikun.pdf
Takimi i dytë me publikun	24.12.2025	https://glogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/12/Njoftimi-i-tubimit-te-dyte-me-publikun-shqip-dhe-serbisht-2025.pdf	https://glogoc.rks-gov.net/procesverbali-i-tubimit-te-dyte-me-publikun-3/

2. Raporti për konsultimet publike për projektaktet komunale (takimet konsultative)

Gjatë periudhës së raportimit, janë organizuar gjithsej **5** takime konsultative për projektaktet komunale, në përputhje me obligimin ligjor të përcaktuar nga Neni 26 i UA për Administratë të Hapur në Komuna. Këto takime u zhvilluan në **objektin kuvendit komunal**, për të siguruar një përfshirje sa më të gjerë të qytetarëve dhe palëve të interesuara.

Grupet e targetuara për këto konsultime përfshinin qytetarët e zakonshëm, përfaqësues të bizneseve lokale, organizatat joqeveritare dhe ekspertët e fushave përkatëse. Takimet u organizuan me qëllim për të mbledhur komente dhe rekomandime mbi projektaktet komunale, si dhe për të siguruar transparencë dhe pjesëmarrje aktive në procesin e hartimit të politikave lokale.

Gjatë këtyre konsultimeve, qytetarët shprehën mendimet dhe shqetësimet e tyre lidhur me çështje të rëndësishme. Shumica e sugjerimeve të dhëna gjatë takimeve u morën parasysh gjatë procesit të finalizimit të projektakteve.

Objektivat e konsultimeve publike u arritën në një masë të kënaqshme, duke përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për proceset vendimmarrëse dhe krijimin e një dialogu të hapur ndërmjet komunitetit dhe administratës komunale.

Në aspektin ligjor, obligimet e përcaktuara për organizimin e këtyre konsultimeve janë përmbushur. Sidoqoftë, janë identifikuar disa sfida, përfshirë vështirësitë në njoftimin e qytetarëve për takimet dhe pjesëmarrjen e ulët në disa zona. Në përgjithësi, këto takime konsultative kanë kontribuar ndjeshëm në përmirësimin e qeverisjes lokale dhe forcimin e partneritetit me qytetarët.

Tabela 2. Raportit për konsultimet publike për projektaktet komunale (takimet konsultative)

Tabela e përgjithshme								
Komuna	Plani i konsultimeve është hartuar dhe publikuar në fillim të vitit (PO/JO)	Numri total i akteve komunale të miratuara, për të cilat kërkohet organizimi i konsultimit publik	Numri i projektakteve për të cilat është organizuar konsultim publik	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë (total) (M . F)		Numri i pjesëmarrësve që kanë ofruar komente gjatë konsultimit	Numri i rekomandimeve/propozimeve të pjesëmarrësve të aprovuara	Numri i raporteve të konsultimit të hartuara dhe publikuara
Komuna e Drenasit	PO	5	5	65	56	0	0	5

Verifikimi i të dhënave			
Emërtimi i Projektaktit	Data e mbajtjes së konsultimit	Linku i njoftimit të publikuar	Linku i publikimit të raportit
Draft-Plani Lokal i Veprimit Zbutës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe dhuna ndaj Grave dhe Vajzave Drenas 2025-2028	14.03.2025	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/03/Draft-%E2%80%9393Plani-Lokal-i-Veprimit-Zbutes-per-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne-Familje-dhe-dhuna-ndaj-Grave-dhe-Vajzave-Drenas-Glllogoc-2025-2028.pdf	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/03/Plani-zbutes-i-LMDHBGJ-per-mbrojtje-nga-DhG-V-Komuna-Drenas-me-plotsime-10.03.2025.docx
Draft-Plani Lokal të Strategjisë së Cilësisë së Ajrit 2025-2029	14.11.2025	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/10/Njoftimi-per-konsultim-publik-per-Draft-Planin-Lokal-te-Strategjise-se-Cilesise-se-Ajrit-dhe-Plani-Lokal-i-Veprimit-ne-Mjedis-2025-2029.pdf	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/12/Raporti-i-Konsultimit-Publik-per-Planin-Lokal-per-Strategjiine-e-Cilesise-se-Ajrit-per-vitet-2025-2029.pdf
Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2025-2029	14.11.2025	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/10/Njoftimi-per-konsultim-publik-per-Draft-Planin-Lokal-te-Strategjise-se-Cilesise-se-Ajrit-dhe-Plani-Lokal-i-Veprimit-ne-Mjedis-2025-2029.pdf	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/12/Konsultimi-publik-per-Planin-Lokal-te-Veprimit-ne-Mjedis-per-vitet-2025-2029.pdf
Draft-Vlerësimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera	04.12.2025	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/11/20251119150208921.pdf	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/12/Raport-i-i-konsultimit-publik-per-Planin-e-Reagimit-Emergjent.pdf
Plani i Reagimit Emergjent për vitet 2026-2029	04.12.2025	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/11/20251119150208921.pdf	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/12/Raport-i-i-konsultimit-publik-per-Planin-e-Vleresimit-te-Rrezikut-nga-Fatkeqesite-Natyrore-dhe-Fatkeqesite-tjera.pdf

3. Raporti për konsultimet publike me shkrim apo elektronike (përdorimi i platformës së konsultimeve publike dhe ueb faqes zyrtare të komunës)

Gjatë periudhës së raportimit, janë realizuar gjithsej **5** konsultime publike me shkrim apo në mënyrë elektronike, duke përfshirë përdorimin e platformës së konsultimeve publike dhe ueb faqes zyrtare të komunës. Këto mekanizma u përdorën për të rritur aksesin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes për projektaktet komunale.

Objektivat kryesore të këtyre konsultimeve ishin të siguronin një proces më të hapur dhe gjithëpërfshirës të hartimit të politikave, duke ofruar qytetarëve një mundësi të drejtpërdrejtë për të kontribuar me idetë e tyre. Në përgjithësi, këto objektiva u arritën, megjithëse pjesëmarrja elektronike mbeti e kufizuar në disa grupe shoqërore për shkak të mungesës së aksesit në teknologji apo njohuri për përdorimin e platformave online.

Në aspektin ligjor, janë përmbushur obligimet për organizimin e konsultimeve publike në këtë format. Si pjesë e përmirësimeve të ardhshme, rekomandohet që të investohet në promovimin më të mirë të këtyre mekanizmave dhe ofrimin e udhëzimeve për përdorimin e tyre nga qytetarët.

Konsultimet publike me shkrim dhe elektronike kanë ndihmuar në forcimin e lidhjes ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve, duke krijuar një hapësirë të sigurt dhe transparente për komunikim dhe vendimarrje të përbashkët.

Tabela 3. Raportit për konsultimet publike me shkrim apo elektronike për projektaktet komunale (përdorimi i platformës së konsultimeve publike dhe në ueb të komunës)

Tabela e përgjithshme					
Komuna	Numri total i akteve komunale të miratuara, për të cilat kërkohet organizimi i konsultimit publik	Numri i projekteve për të cilat është organizuar konsultim publik në platformën e konsultimeve	Numri i pjesëmarrësve që kanë ofruar komente gjatë konsultimit	Numri i rekomandimeve/propozimeve të pjesëmarrësve të aprovuara	Numri i raporteve të konsultimit të hartuara dhe publikuara në platformën e konsultimeve
Komuna e Drenasit	5	5	0	0	5

Verifikimi i të dhënave			
Emërtimi i Projektaktit	Data e fillimit të konsultimit	Linku i konsultimit (platforma e konsultimeve, ueb-i i komunës)	Linku i publikimit të raportit
Draft-Plani Lokal i Veprimt Zbutës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe dhuna ndaj Grave dhe Vajzave Drenas 2025-2028	14.03.2025	https://konsultimet.rks-gov.net/consulttionsList.php	https://konsultimet.rks-gov.net/consulttionsList.php
Draft-Plani Lokal të Strategjisë së Cilësisë së Ajrit 2025-2029	14.11.2025	https://konsultimet.rks-gov.net/consulttionsList.php	https://konsultimet.rks-gov.net/consulttionsList.php
Plani Lokal i Veprimt në Mjedis 2025-2029	14.11.2025	https://konsultimet.rks-gov.net/consulttionsList.php	https://konsultimet.rks-gov.net/consulttionsList.php
Draft-Vlerësimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera	04.12.2025	https://konsultimet.rks-gov.net/consulttionsList.php	https://konsultimet.rks-gov.net/consulttionsList.php
Plani i Reagimit Emergjent për vitet 2026-2029	04.12.2025	https://konsultimet.rks-gov.net/consulttionsList.php	https://konsultimet.rks-gov.net/consulttionsList.php

4. Raporti i dëgjimeve buxhetore me qytetarë

Gjatë periudhës së raportimit, janë organizuar gjithsej **11** dëgjime buxhetore me qytetarë, duke përfshirë diskutimet për Kornizën Afatmesme të Buxhetit (KAB), Draftin e Buxhetit dhe procesin e buxhetimit me pjesëmarrje. Këto dëgjime u mbajtën në **9** lokacione të ndryshme për të siguruar përfshirje të gjerë dhe të barabartë të komunitetit.

Në këto takime morën pjesë gjithsej **414** qytetarë, prej të cilëve **39** parashtruan komente dhe rekomandime të vlefshme. Janë pranuar **37** komente, të cilat kryesisht lidhen me **investimet infrastrukturore, shërbimet publike, etj.**

Objektivat kryesore të dëgjimeve buxhetore ishin të rrisnin transparencën, të angazhonin qytetarët në procesin e planifikimit financiar dhe të siguronin përfshirjen e perspektivave të ndryshme në vendimmarrjen buxhetore. Në përgjithësi, këto objektiva janë arritur, pasi dëgjimet mundësuan një dialog të hapur ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve, si dhe një kuptim më të mirë të prioritetëve të komunitetit.

Në aspektin ligjor, janë përmbushur të gjitha obligimet për organizimin e dëgjimeve buxhetore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe administrative. Megjithatë, disa sfida të identifikuara përfshijnë përfshirjen e ulët në disa zona rurale dhe mungesën e burimeve për të organizuar aktivitete më gjithëpërfshirëse.

Në përgjithësi, dëgjimet buxhetore kanë kontribuar në ndërtimin e një procesi më transparent dhe pjesëmarrës të menaxhimit të buxhetit, duke përforcuar lidhjen ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve përmes përfshirjes aktive në vendimmarrje.

Tabela 4. Raporti për dëgjimet buxhetore me qytetarë për KAB

Tabela e përgjithshme							
Komuna	Numri i dëgjimeve buxhetore me qytetarë të organizuara	Numri i pjesëmarrësve në dëgjime buxhetore (në total)	Numri i pjesëmarrësve që kanë ofruar propozime	Numri i propozimeve të pranuar	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë (M. / F)		Numri i procesverbaleve të hartuara dhe publikuara pas takimeve
Komuna e Drenasit	2	115	20	20	74	41	2

Verifikimi i të dhënave			
Dëgjimi buxhetor për KAB	Data e takimit	Linku i njoftimit të publikuar	Linku i procesverbalit
Dëgjimi i parë buxhetor për KAB	26.05.2025	https://glllogoc.rks-gov.net/news/f-t-e-s-e-21/	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Procesverbali-i-takimit-te-pare-konsultativ-publik-per-Kornizen-Afatmesme-Buxhetore-KAB-2026-2028.pdf
Dëgjimi i dytë buxhetor për KAB	26.05.2025	https://glllogoc.rks-gov.net/news/f-t-e-s-e-21/	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Procesverbali-i-takimit-te-dyte-konsultativ-publik-per-Kornizen-Afatmesme-Buxhetore-KAB-2026-2028.pdf

Tabela 5. Raportit për dëgjimet buxhetore me qytetarë për Draft buxhetin

Tabela e përgjithshme							
Komuna	Numri i dëgjimeve buxhetore me qytetarë të organizuara	Numri i pjesëmarrësve në dëgjime buxhetore (në total)	Numri i pjesëmarrësve që kanë ofruar propozime	Numri i propozimeve të pranuar	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë (M. / F)		Numri i procesverbaleve të hartuara dhe publikuara pas takimeve
Komuna e Drenasit	9	298	19	17	182	116	9

Verifikimi i të dhënave			
Dëgjimi buxhetor për Draft Buxhetin	Data e takimit	Linku i njoftimit të publikuar	Linku i procesverbalit
Dëgjimi i parë buxhetor për Draft Buxhetin	18.08.2025	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-vitin-2026.pdf	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/10/20251006163506811.pdf
Dëgjimi i dytë buxhetor për Draft Buxhetin	18.08.2025	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-vitin-2026.pdf	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/10/20251006163506811.pdf
Dëgjimi i tretë buxhetor për Draft Buxhetin	19.08.2025	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-vitin-2026.pdf	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/10/20251006163626076.pdf
Dëgjimi i katërt buxhetor për Draft Buxhetin	19.08.2025	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-vitin-2026.pdf	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/10/20251006163454628.pdf

Dëgjimi i pestë buxhetor për Draft Buxhetin	20.08.2025	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-vitin-2026.pdf	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/10/20251006163615126.pdf
Dëgjimi i gjashtë buxhetor për Draft Buxhetin	20.08.2025	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-vitin-2026.pdf	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/10/20251006163553813.pdf
Dëgjimi i shtatë buxhetor për Draft Buxhetin	21.08.2025	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-vitin-2026.pdf	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/10/20251006163553813.pdf
Dëgjimi i tetë buxhetor për Draft Buxhetin	21.08.2025	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-vitin-2026.pdf	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/10/20251006163553813.pdf
Dëgjimi buxhetor nga Komiteti për Politikë dhe Financa	05.09.2025	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-vitin-2026.pdf	https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/10/procesverbali-i-degjimeve-buxhetore.pdf

Tabela 6. Raportit për dëgjimet buxhetore me qytetarë në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje

Tabela e përgjithshme							
Komuna	Numri i dëgjimeve buxhetore me qytetarë të organizuara	Numri i pjesëmarrësve në dëgjime buxhetore (në total)	Numri i pjesëmarrësve që kanë ofruar propozime	Numri i propozimeve të pranuar	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë (M. / F)		Numri i procesverbaleve të hartuara dhe publikuara pas takimeve
Komuna e Drenasit							

Bekim Dobra

Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun



*Sqarim: Tabela 6 e raportit për dëgjimet buxhetore me qytetarët në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje nuk është relevante për komunën e Drenasit, pasi ajo nuk është përfshirë në këtë proces.